

# FINANCA

Ditari Mujor | Prill 2024



## Rinohet Marrëveshja e Ndhmës për Objektivat Zhvillimi ndërmjet Qeverisë Shqiptare dhe SHBA

Qeveria Shqiptare ka nënshkruar rinovimin e marrëveshjes së ndihmës për objektiva zhvillimi me Qeverinë e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, "Për forcimin e shtetit të drejtës dhe qeverisjes së mirë dhe krijimin e kushteve për një rritje ekonomike me bazë të gjerë dhe të qëndrueshme". Gjatë ceremonisë së zhvilluar në Ambasadën e SHBA-ve, Ministri i Financave u shpreh se rinovimi i marrëveshjes deri në vitin 2030, duke e çuar vlerën e përgjithshme të financimit deri në 97 milionë dollarë, është një tjetër dëshmi e mbështetjes së vazhdueshme të Qeverisë Amerikane për Shqipërinë, mbështetje e cila bëhet edhe më e rëndësishme për vetë stadin në të cilin ndodhet aktualisht vendi ynë në procesin e negociatave dhe përpjekjet për t'u afruar më shpejt me BE. Marrëveshja, e ratifikuar fillimisht në fund të vitit 2013, ka ofruar mbështetje serioze për ndërmarrjen e reformave të rëndësishme në fusha si, të drejtat e njeriut, qeverisja, zhvillimi ekonomik, paqja dhe siguria.

LEXO MË SHUMË

## Ministri Mete zhvilloi takime me zyrtarë të lartë të FMN dhe BB gjatë Mbledhjeve të Pranverës 2024

Në datat 18-21 prill 2024, u zhvilluan Mbledhjet e Pranverës të FMN dhe Grupit të BB, në Uashington. Shqipëria u përfaqësua në këto takime nga një delegacion i përbashkët i përbërë nga Ministri i Financave, Ervin Mete, Guvernatori i BSH, Gent Sejko, si dhe drejtues të tjerë të lartë të dy institucioneve. Delegacioni shqiptar zhvilloi disa takime me zyrtarë të lartë të institucioneve financiare ndërkombëtare, gjatë të cilave i njohën të pranishmit me zhvillimet më të fundit në ekonominë shqiptare, reformat e ndërmarra, si edhe pritshmëritë për periudhën në vazhdim. Përfaqësuesit e lartë të FMN-së dhe BB-së veçuan si një zhvillim pozitiv rritjen e vlerësimit për herë të parë të agjencisë Standard & Poor's për kreditin e Shqipërisë, i cili u pasua nga një rishikim në rritje i perspektivës edhe nga agjencia Moody's, si edhe theksuan se dalja e vendit nga lista gri e FATF/MONEYVAL është gjithashtu një lajm me efekte shumë pozitive për Shqipërinë.

LEXO MË SHUMË



LEXO MË SHUMË

## Ministri Mete nënshkruan marrëveshjen me BB, 80 milionë dollarë për projektin në mbështetje të turizmit të qëndrueshëm

Ministri i Financave, Ervin Mete, nënshkroi me Zv. Presidenten e Bankës Botërore, znj. Antonella Bassani, marrëveshjen e financimit të projektit "Mjedisi pastër dhe i qëndrueshëm për Detin Blu". Objektivi i projektit, për të cilin Banka Botërore do të japë një financim prej 80 milionë dollarësh, është reduktimi i ndotjes në mjedisin ujor (detëra, lumenj) në zonën jugperëndimore, në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm të turizmit. Projekti është i ndarë në tre komponentë, ku pjesa e parë ka të bëjë me promovimin e një qasjeje të integruar dhe qarkulluese për mbrojtjen e mjedisit dhe burimeve ujore; pjesa e dytë synon uljen e ndotjes në Lumin Vjosa, kjo edhe në kuadër të mbështetjes dhe mbrojtjes së mëtejshme të tij, pas akordimit të statusit "Park Kombëtar", si lumi i fundit i egër në Europë; ndërsa pjesa e tretë parashikon aspekte të menaxhimit, monitorimit dhe vlerësimit sa i përket zbatimit të këtij projekti, i cili parashikohet të zgjasë deri në mars të vitit 2029.

## Performanca Paraprake e të Ardhurave dhe Shpenzimeve për 3-mujorin 2024

Performanca paraprake e treguesve fiskalë të konsoliduar për 3-mujorin e parë të vitit 2024 reflekton ecurinë e mbledhjes së të ardhurave dhe realizimit të shpenzimeve. Të ardhurat totale, për tre-mujorin e parë të vitit 2024 u realizuan në masën 105.1% të planit të së njëjtës periudhë. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, u mblodhën 7.64 miliardë lekë më shumë, ose 4.9% më shumë se tre-mujori i vitit. Shpenzimet e përgjithshme publike për periudhën 3 mujore të vitit 2024, arritën në rreth 130.4 miliardë lekë, me një realizim në masën 96% të planit të së njëjtës periudhë, ndërsa krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2023, shpenzimet e përgjithshme publike rezultojnë 4.1% më të larta, ose 5.1 miliardë lekë më shumë. Niveli i suficitit në periudhën 3 mujore të vitit 2024 rezultoi në rreth 33.3 miliardë lekë.

LEXO MË SHUMË

### TË ARDHURAT TOTALE

Për 3-mujorin e vitit 2024 u realizuan në masën

163.8 miliardë Lekë



Realizimi: 105.1% e planit të së njëjtës periudhë



## Takimi i Ministrave të Çështjeve Evropiane dhe Financave të Ballkanit Perëndimor në Podgoricë

Ministri i Financave, Ervin Mete, mori pjesë në takimin e Ministrave të Çështjeve Evropiane dhe Financave të Ballkanit Perëndimor në Podgoricë të Malit të Zi. Ky takim u zhvillua pas miratimit

nga Parlamenti Evropian të Paketës prej 6 miliardë eurosh të Planit të ri të Rritjes për vendet e Ballkanit Perëndimor. Ministri i Financave, në fjalën e tij, u shpreh se kjo Paketë Financiare është një shenjë e qartë e mbështetjes së BE për përpjekjet dhe procesin e integritetit të rajonit. Ai theksoi rëndësinë e anëtarësimit të Shqipërisë dhe vendeve të Ballkanit Perëndimor në Zonën e Vetme të Pagesave në Euro (SEPA) dhe përparimet e bëra në këtë drejtim. Ministri Mete tha se Shqipëria është një fazë të avancuar sa i përket përmbushjes së kriterëve të BE-së për SEPA-n, ndërsa ka realizuar procedurën e para-aplikimit. Përfshirja në Zonën e Vetme Evropiane të Pagesave sjell përfitime të shumta për vendet e rajonit, si reduktimin e kostove të transaksioneve bankare dhe lehtësimin e tregtisë.

LEXO MË SHUMË



## Ministri Mete takohet me drejtues të lartë të Doganave Italiane dhe Guardia di Finanza

Ministri i Financave priti në një takim Drejtorin e Përgjithshëm të Agjencisë së Doganave

dhe Monopoleve të Italisë, z. Roberto Alesse dhe Komandantin e Përgjithshëm të Guardia di Finanza, z. Andrea De Gennaro, në kuadër të një vizite zyrtare në Tiranë. Gjatë takimit u vlerësuan marrëdhëniet dhe bashkëpunimi i deritanishëm mes administratave doganore të dy vendeve dhe u theksua rëndësia e forcimit të mëtejshëm në të ardhmen. Palët biseduan mbi lehtësimin e shkëmbimeve tregtare mes dy vendeve, përputhjen e procedurave doganore me standardet e BE, rritjen e mëtejshme të sigurisë ndërkufitare dhe luftën kundër aktivitetëve të paligjshme. Ministri Mete shprehur angazhimin e Ministrisë së Financave dhe institucioneve të saj për të rritur nivelin e bashkëpunimit mes Shqipërisë dhe Italisë.

LEXO MË SHUMË